



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL**

**Nr. 11243-02403-00-2012 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2016-2932 i Vendimit (265)**

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë:

Artan BROCI	- Kryesues
Aleksandër MUSKAJ	- Anëtar
Mirela FANA	- Anëtar
Guxim ZENELAJ	- Anëtar
Admir THANZA	- Anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 16.11.2016, mori në shqyrtim çështjen civile me nr.11243-02403-00-2012, që u përket palëve:

KËRKUES: **Zyra e Gjendjes Civile Shkodër.**

OBJEKTI: *Rishikim i vendimit civil të formës së prerë nr.1119, datë 02.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

BAZA LIGJORE: *Neni 494 pika ç e Kodit të Procedurës Civile.*

Për çështjen me palë:

KËRKUES: **Kostaq Papa.**

PERSON I TRETË: **Z.Gj.Civile Shkodër.**

ME OBJEKT: *Pasaktësinë e aktit të lindjes.
Vërtetimin e faktit juridik të lindjes me datë 14.05.1965 në Delvinë të Rrethit Sarandë.*

BAZA LIGJORE: *Neni 39 i ligjit nr.8950, datë 10.10.2002, nenet 32 e 388 të K.Pr.Civile.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.1119, datë 02.07.2003, ka vendosur:
“Pasaktësinë e aktit të lindjes së kërkuesit Kostaq Papa, për sa i përket datëlindjes dhe vendlindjes së tij.

Vërtetimin e faktit juridik të lindjes së kërkuesit Kostaq Papa me datë 14.05.1965 në Delvinë të rrethit të Sarandës.

Urdhërohet personi i tretë, Zyra Gjendjes Civile Shkodër, të bëjë ndryshimet në aktin e lindjes së kërkuesit Kostaq Papa për sa i përket datëlindjes dhe vendlindjes së tij.”

Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 17.07.2003, pasi personi i tretë Zyra Gjendjes Civile Shkodër nuk ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Në datën 23.07.2012, është regjistruar me Nr. Prot, S-262 kërkesa e kërkuesit Zyra Gjendjes Civile Shkodër me objekt: “Rishikimi i vendimit civil të formës së prerë nr.1119, datë 02.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, duke parashtruar ndër të tjera se:

- *Është provuar se nga vendimet e mësipërme është provuar se dokumente e përdorura nga kërkuesi Kostaq Papa (Arbën Hasanaj) për korrigjimin e aktit të lindjes kanë rezultuar të falsifikuara me vendim penal të formës së prerë.*
- *Konkretisht vërtetimi i shkollës “Ismail Qemali” si dhe dokumenti për vërtetimin e letërnjoftimit nga komisariati i policisë Larisa- Greqi.*
- *Në rastin konkret jemi përpara kushteve të parashikuara në nenin 494/ç, të Kodit të Procedurës Civile.*

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Artan Broci, dhe diskutoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

1. Në Gjykatën e Lartë është regjistruar çështja nr.11243-02403-00-2012 regj. them, që u përket palëve ndërgjyqëse: kërkues Zyra e Gjendjes Civile Shkodër dhe me objekt: *“Rishikim i vendimit civil të formës së prerë nr.1119, datë 02.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.*

I. Rrethanat e çështjes:

2. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore rezulton se kërkuesi Kostaq Papa i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesën me objekt: *“Pasaktësinë e aktit të lindjes. Vërtetimin e faktit juridik të lindjes me datë 14.05.1965 në Delvinë të Rrethit Sarandë”,* pasi në Z.Gj.Civile Shkodër kërkuesi rezulton i datëlindjes 30.06.1968 e me vendlindje Shkodër.

3. Në këtë gjykim kërkuesi ka pretenduar se babai i tij duke qenë me profesion oficer aktiv, që në vitin 1961 ka lëvizur për shkak të profesionit të tij nga Përmeti në Sarandë në vitin 1962 e më pas nga 1968 ka lëvizur me gjithë familjen në Shkodër. Në kohën e lindjes së kërkuesit Kostaq Papa babai i tij Dule Hasani është transferuar nga Delvina në Shkodër pa e regjistruar të birin e tij të porsalindur në Z.Gj.Civile Delvine. Në vitin 1968, kohë në të cilën ka ardhur në Shkodër me shërbim, e ka regjistruar në Z.Gj.Civile Shkodër me datëlindje 30.06.1968. Pra e ka regjistruar afro tre vite me të vogël.

4. Kërkuesi ka ndryshuar emrin dhe mbiemrin e tij me vendimin nr.28, datë 15.03.1999, të Këshillit Bashkiak Shkodër, nga Arbën Hasani në Kostaq Papa.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.1119, datë 02.07.2003, ka vendosur:
“Pasaktësinë e aktit të lindjes së kërkuesit Kostaq Papa, për sa i përket datëlindjes dhe vendlindjes së tij.

Vërtetimin e faktit juridik të lindjes së kërkuesit Kostaq Papa me datë 14.05.1965 në Delvinë të rrethit të Sarandës.

Urdhërohet personi i tretë, Zyra Gjendjes Civile Shkodër, të bëjë ndryshimet në aktin e lindjes së kërkuesit Kostaq Papa për sa i përket datëlindjes dhe vendlindjes së tij.”

6. Gjykata e rrethit gjyqësor ndër të tjera arsyeton:

Por ndryshe, nga sa rezulton në aktet e gjendjes civile, u provua përpara gjykatës.

Si fillim kërkuesi provoi se babai i tij, duke qenë me profesion oficer aktiv, që në vitin 1961 ka lëvizur për shkak të profesionit të tij nga Përmeti në Sarandë në vitin 1962 e me pas nga 1968 ka lëvizur me gjithë familjen në Shkodër. Në kohën e lindjes së kërkuesit Kostaq Papa babai i tij Dule Hasani është transferuar nga Delvina në Shkodër pa e regjistruar të birin e tij të porsalindur në Z.Gj.Civile Delvine. Në vitin 1968, kohe në të cilën ka ardhur në Shkodër me shërbim, e ka regjistruar në Z.Gj.Civile Shkodër me datëlindjes 30.06.1968. Pra e ka regjistruar afro tre vite me të vogël. Fakti që babai i kërkuesit ka qenë oficer u provua me prova shkresore të administruara, si diploma e Shkollës Ushtarake, libreza e ushtarakut dhe një dekorate e tij.

U provua gjithashtu së kërkuesi ka ndryshuar emrin dhe mbiemrin e tij me vendimin nr.28, datë 15.03.1999 të Këshillit Bashkiak Shkodër, nga Arbën Hasani në Kostaq Papa. Kjo sipas shënimit në çertifikatën e lindjes nr.112/196 e vitit 1974, lëshuar me datë 02.07.2003 nga Z.Gj.Civile Shkodër.

Me një fillim prove me shkresë kërkuesi provoi se figuron i regjistruar në amzën e shkollës 8-vjeçare “Ismail Qemali”, shkollë në të cilën ka kryer klasën e VIII-të në vitin shkollor 1982-1983. Kjo sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtori i shkollës Kujtim Dervishi. Mbi bazën e këtij vërtetimi gjykata krijon bindjen se Arbën Hasani, që është kërkuesi me emrin e tij të mëparshëm para sa ta ndryshonte në Kostaq Papa me vendimin e Këshillit Bashkiak me kërkesë të tij, duke qenë se ka kryer shkollën 8-vjeçare në vitin shkollor 1982-1983 duhet të jetë i vtl. 1965 dhe jo i vtl. 1968.

Sipas një dokumenti për vërtetimin e letërnjoftimit nga Komisariati i Policisë Larisa Greqi, kërkuesi Kostaq Papa si emigrant në Greqi është regjistruar me datëlindjen e tij të saktë, 14.05.1965 me vendlindje Delvinë.

Gjithashtu gjykata gjatë pyetjeve të dëshmitareve Astrit Zaganjori e Artan Kajo dhe deklarimeve të tyre, krijoi bindjen së kërkuesi është i datëlindjes 14.05.1965 dhe se ka lindur në Delvinë.

Në këto kushte gjykata çmon së kërkesa e kërkuesit Kostaq Papa është e drejtë, e mbështetur në ligj e në prova e si e tillë duhet pranuar.

7. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 17.07.2003, pasi personi i tretë Zyra Gjendjes Civile Shkodër nuk ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

II. Ligji i zbatueshëm:

Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile në të cilat është parashikuar:

Neni 445:

Ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe rishikimi nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit.

Neni 494/a:

Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj;

Neni 496:

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijëni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se një vit nga dita që ka lindur shkakun i rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495, afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë.

Neni 497:

Kërkesa për rishikim paraqitet përpara Gjykatës së Lartë. Kërkesa duhet të përmbajë: shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, provat përkatëse që lidhen me një nga kërkesat e nenit 494 të këtij Kodi, ditën e zbulimit apo të vërtetimit të rrethanës apo marrjes së dokumenteve.

Neni 498:

Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson:

8. Në datën 23.07.2012, është regjistruar me Nr. Prot, S-262 kërkesa e kërkuarit Zyra Gjendjes Civile Shkodër me objekt: “*Rishikimi i vendimit civil të formës së prerë Nr. 1119, datë 02.07.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*”, duke parashtruar shkaqet e lartpërmendura.

9. Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konstaton se jemi përpara shqyrtimit të një kërkesë bazuar në nenin 494 të K.Pr.Civile ku shprehimisht thuhet se: “*Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës*”.

10. Mënyra se si kërkuari ka paraqitur kërkesën e tij për rishikim, e detyrojnë Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë që fillimisht të analizojë në këtë vendim rëndësinë e institutit të rishikimit si dhe afatet dhe mënyrën se si ai mund të ushtrohet për të qenë efektiv.

11. Rishikimi gjyqësor si institut nuk është gjë tjetër veçse, një mjet për të kundërshtuar një vendim gjyqësor që ka marrë formë të prerë. Kjo e drejtë procedurale, që përbën një mjet të jashtëzakonshëm ankimi, bëhet vetëm për shkaqe të parashikuara në nenin 494 të K.Pr.Civile dhe është e kufizuar, pasi ka të bëjë me një situatë të supozuar jonormale, e cila e ka penguar gjykatën që të zbatojë drejtë ligjin dhe të zgjidhë drejtë çështjen. Kjo e drejtë procedurale në mënyrë që të jetë efektive dhe të merret në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Lartë, (në rast se plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 494 të K.Pr.Civile), duhet të ushtrohet nga pala e interesuar brenda afateve të parashikuara shprehimisht në ligj, konkretisht në nenin 496 të K.Pr.Civile.

12. Rezulton që vendimi i cili kërkohet të rishikohet nga ana e kërkuarit është vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr.1119, datë 02.07.2003. Kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë është depozituar pranë Gjykatës së Lartë në datën 23.07.2012. Rezulton që

shkaku i rishikimit, ka lindur në datë konkretisht vendimit penal nr.311, datë 17.11.2009, të Gjykatës së Apelit Shkodër rezulton se ky vendim mban datën 17.11.2009, ndërsa kërkesa për rishikim është paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, në datën 23.07.2012. Kërkuesi Zyra e Gjendjes Civile në të njëjtën kohë është vënë në dijeni nëpërmjet një procesi të dytë gjyqësor në të cilin është palë dhe është dhënë vendimi nr.1320, datë 16.05.2012 dhe për këtë vendim është vënë në dijeni në datën 04.06.2012.

13. Pra në analizë të sa më sipër, kjo kërkesë është jashtë afatit 30 ditor nga dita që kërkuesit kanë marrë dijeni për shkakun e rishikimit dhe brenda afatit një vjeçar nga dita që ka lindur shkaku i rishikimit (neni 445 dhe neni 496 i K.Pr.Civile).

14. Në mbështetje të kërkesës për rishikim dhe bazës ligjore të referuar kërkuesi i ka paraqitur gjykatës **vendimin penal nr.311, datë 17.11.2009**, të Gjykatës së Apelit Shkodër, në të cilin është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit Kostaq Papa (Arben Hasanaj) për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të pasaportës. Në këtë vendim në pjesën urdhëruese është disponuar për asgjësimin e pasaportës ndërkohë që për falsifikimin e dokumenteve të cilat janë përdorur gjatë procesit civil janë përmendur si të falsifikuara vetëm gjatë pjesës arsyetuese të këtij vendimi penal.

15. Nisur nga natyra që paraqet kërkesa për rishikim, e cila konsiderohet “si mjet i jashtëzakonshëm” për efekt të sigurisë juridike, ajo nuk mund të paraqitet sa here që palët që kanë marrë pjese në një gjykim gjejnë nga një prove të re dhe sa here që ato mendojnë se fakte, prova, dëshmitare apo ngjarje, të cilat i nënshtroheshin gjykimit të zakonshëm duhet të trajtohen në kërkesën për rishikim. Kërkesa për rishikim në të cilën jepet shkaku /shkaqet e rishikimit dhe që parashikohet nga neni 494 i K.Pr.Civile paraqitet vetëm brenda afateve dhe kushteve të parashikuara shprehimisht në ligj.

16. Referuar nenit 445 të K.Pr.Civile: *“Ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe rishikimi nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit”*. Kurse në nenin 496 të K.Pr.Civile do të gjejmë të shprehur qe: *“Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se një vit nga dita që ka lindur shkaku i rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495, afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë”*.

17. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 20/2008 ndër të tjera përcakton:

.... kjo Gjykatë çmon se është e domosdoshme të ballafaqojë përmbajtjen e nenit 445 të K.Pr.Civile e ato të dispozitave të kapitullit të tretë që trajtojnë institutin e rishikimit (nenet 494-498), veçanërisht me përmbajtjen e nenit 496 të këtij Kodi. Këto dy dispozita dallojnë nga njëra tjetra sepse: (i) neni 445 sanksionon prekluzivitetin (afatin) e ankimit si mjet procedural për të gjitha llojet e ankimit përfshirë dhe kërkesën për rishikim, duke patur parasysh se zë vend në titullin e parë të pjesës së tretë të Kodit, kurse neni 496 sanksionon afatin ligjor vetëm përsa i përket kërkesës për rishikim që zë vend në titullin e tretë të pjesës së tretë të Kodit; (ii) neni 445 përcakton vetëm ankimin një vjeçar nga shpallja e vendimit, kurse neni 496 përcakton afatin një vjeçar që nga dita që ka lindur shkaku i rishikimit; (iii) neni 445 nuk ka si qëllim përcaktimin e afatit për ankim, ndërsa neni 496 saktëson afatin 30 ditor si determinat nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit.

18. Vendimi i gjykatës kushtetuese nr. 38/2012 nder të tjera percakton:

*Neni 445 i KPC-së parashikon se: “ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe rishikimi nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit”, kurse neni 496 i KPC-së parashikon se: “kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dënimin për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se një vit nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit.” Këto dy dispozita dallojnë nga njëra tjetra sepse: (i) neni 445 sanksionon prekluzivitetin (afatin) e ankimit si mjet procedural për të gjitha llojet e ankimit përfshirë dhe kërkesën për rishikim, duke pasur parasysh se zë vend në titullin e parë të pjesës së tretë të Kodit, kurse neni 496 sanksionon afatin ligjor vetëm për sa i përket kërkesës për rishikim që zë vend në titullin e tretë të pjesës së tretë të Kodit; (ii) neni 445 percakton vetëm ankimin një vjeçar nga shpallja e vendimit, kurse neni 496 percakton afatin një vjeçar që nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit; (iii) neni 445 nuk ka si qëllim përcaktimin e afatit për ankim, **ndërsa neni 496 saktëson afatin 30 ditor si determinant nga dita që pala ka marrë dënimin për shkakun e rishikimit.** Gjykata ka vlerësuar se në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i KPC-së duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të KPC-së për sa i përket afatit prekluziv një vjeçar për pasojë, paraqitja e kërkesës tej këtij afati e bën atë të papranueshme. Pra, ky afat llogaritet ose nga momenti që është shpallur vendimi që ankimohet ose nga momenti që merr formë të prerë vendimi që përmban shkakun e rishikimit të parashikuar nga neni 494 i KPC-së. Nëse nuk do të interpretohej në këtë mënyrë, neni 445 i KPC-së ashtu si është shkruar do të ishte i paaplikueshëm, duke ia ngushtuar hapësirat individit për të pasur akses në gjykatë dhe për të shfrytëzuar mjetin procedural të jashtëzakonshëm të kërkesës për rishikim (shih vendimin nr. 20, datë 29.09.2008 të Gjykatës Kushtetuese).*

19. Në përfundim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në analizë të sa më sipër, çmon se kërkesa për rishikim objekt gjykimi është paraqitur jashtë afatit 30 ditor e si rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 490 të K.Pr.Civile.

V E N D O S I

Rrëzimin e kërkesës së Zyrës së Gjendjes Civile Shkodër, për rishikimin e vendimit nr.1119, datë 02.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për shkak të paraqitjes së kërkesës jashtë afatit 30 ditor.

Tiranë më 16.11.2016

A N Ë T A R
Kundër
Aleksandër MUSKAJ

A N Ë T A R
Mirela FANA

K R Y E S U E S
Artan BROCI

A N Ë T A R

Guxim ZENELAJ

Vërtetohet njësia me origjinalin P.Adm.Gjyq. D.Qerimi B.A.

A N Ë T A R

Admir THANZA

MENDIM PAKICE

Unë gjyqtari Aleksandër Muskaj ndaj mendim ndryshe nga mendimi i gjyqtarëve në shumicë në lidhje me zgjidhjen e kërkesës për rishikim që ka paraqitur Zyra e Gjendjes Civile Shkodër dhe konkretisht *jam për pranimin e kërkesës së Zyrës së Gjendjes Civile Shkodër, dhe rishikimin e vendimit civil Nr.1119, datë 02.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

Mendimi im në pakicë argumentohet si më poshtë:

Kërkuesi Kostaq Papa i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesën me objekt: *“Pasaktësinë e aktit të lindjes. Vërtetimin e faktit juridik të lindjes me datë 14.05.1965 në Delvinë të Rrethit Sarandë”*, pasi në Z.Gj.Civile Shkodër kërkuesi rezulton i datëlindjes 30.06.1968 e me vendlindje Shkodër.

Në këtë gjykim kërkuesi ka pretenduar se, i ati i tij duke qenë me profesion oficer aktiv, që në vitin 1961 ka lëvizur për shkak të profesionit të tij, nga Përmeti në Sarandë në vitin 1962 e më pas, nga viti 1968 ka lëvizur me gjithë familjen në Shkodër. Në kohën e lindjes së kërkuesit Kostaq Papa, i ati i tij Dule Hasani është transferuar nga Delvina në Shkodër, pa e regjistruar të birin të porsalindur, në Z.Gj.Civile Delvine. Në vitin 1968, kohë në të cilën ka ardhur në Shkodër me shërbim, e ka regjistruar në Z.Gj.Civile Shkodër me datëlindje 30.06.1968. Pra e ka regjistruar afërsisht tre vite me të vogël.

Kërkuesi ka ndryshuar emrin dhe mbiemrin e tij me vendimin Nr.28, datë 15.03.1999, të Këshillit Bashkiak Shkodër, nga Arbën Hasani në Kostaq Papa.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin Nr.1119, datë 02.07.2003, ka vendosur: *“Pasaktësinë e aktit të lindjes së kërkuesit Kostaq Papa, për sa i përket datëlindjes dhe vendlindjes së tij.*

Vërtetimin e faktit juridik të lindjes së kërkuesit Kostaq Papa me datë 14.05.1965 në Delvinë të rrethit të Sarandës.

Urdhërohet personi i tretë, Zyra Gjendjes Civile Shkodër, të bëjë ndryshimet në aktin e lindjes së kërkuesit Kostaq Papa për sa i përket datëlindjes dhe vendlindjes së tij.”

Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 17.07.2003, pasi personi i tretë Zyra Gjendjes Civile Shkodër nuk ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Në mbështetje të kërkesës për rishikim dhe bazës ligjore të referuar, kërkuesi i ka paraqitur gjykatës vendimin penal Nr.311, datë 17.11.2009, të Gjykatës së Apelit Shkodër, në të cilin është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit Kostaq Papa (Arben Hasanaj) për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të pasaportës. Në këtë vendim, në pjesën urdhëruese është disponuar për

asgjësimin e pasaportës ndërkohë që, për falsifikimin e dokumenteve të cilat janë përdorur gjatë procesit civil janë përmendur si të falsifikuara vetëm gjatë pjesës arsyetuese të këtij vendimi penal.

Neni 445 i K.Pr.C-së parashikon se: *“ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe rishikimi nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit”*, kurse neni 496 i KPC-së parashikon se: *“kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijëni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se një vit nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit.”*

Ashtu sikundër arsyetohet dhe shumica në vendimin e saj, rezulton që, vendimi i cili kërkohet të rishikohet nga ana e kërkuesit është vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër Nr.1119, datë 02.07.2003.

Kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë është depozituar pranë Gjykatës së Lartë në datën 23.07.2012. Rezulton që shkakun e rishikimit, ka lindur me vendimin penal Nr.311, datë 17.11.2009, të Gjykatës së Apelit Shkodër. Ky vendim mban datën 17.11.2009, ndërsa kërkesa për rishikim është paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, në datën 23.07.2012.

Por për të analizuar nëse, kërkesa është apo jo brenda afatit ligjor duhet patur parasysh fakti se (kërkuesi) Zyra e Gjendjes Civile është vënë në dijëni nëpërmjet një procesi të dytë gjyqësor në të cilin është palë dhe pikërisht është dhënë vendimi Nr.1320, datë 16.05.2012 dhe për këtë vendim Zyra e Gjendjes Civile është vënë në dijëni në datën 04.06.2012.

Pra duke patur parasysh faktin se, data e marrjes dijëni të kërkuesit për këtë fakt të ri, është data 04.06.2012 deri në datën e dorëzimit të kërkesës për rishikim në datë 23.07.2012, pakica mendon se jemi brenda afatit ligjor të rishikimit dhe për këtë arsye kërkesa për rishikim duhet të pranohet.

G J Y Q T A R

Aleksandër MUSKAJ